United Nations
Nations Unies

International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

Tribunali Penal
Ndërkombëtar për
ish-Jugosllavinë

# AKTAKUZË

# MILLOSHEVIQ, MILLUTINOVIQ, SHAINOVIQ, OJDANIQ & STOJILKOVIQ

**"Kosovo"**

IT-99-37

Dorëzuar nga Prokurorja: 22 maj 1999
Konfirmuar nga nj? gjykat?s: 24 maj 1999

***Outreach Programme / Programi i Përhapjes***
Churchillplein 1, 2517 JW The Hague. P.O. Box 13888, 2501 EW The Hague. Netherlands
Tel.: +31 70 512 5493/8274 Fax: +31 70 512 8953
Internet address: http://www.un.org/icty

**TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË**

**PROKURORJA E TRIBUNALIT**

**KUNDËR**

**SLLOBODAN MILLOSHEVIQIT**

**MILLAN MILLUTINOVIQIT**

**NIKOLLA SHAINOVIQIT**

**DRAGOLUB OJDANIQIT**

**VLLAJKO STOJILKOVIQIT**

# AKTAKUZË

Prokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, në përputhje me kompetencat e saj sipas Nenit 18 të Statutit të Tribunalit, akuzon:

**SLLOBODAN MILLOSHEVIQIN**

**MILLAN MILLUTINOVIQIN**

**NIKOLLA SHAINOVIQIN**

**DRAGOLUB OJDANIQIN**

**VLLAJKO STOJILKOVIQIN**

Për **KRIME KUNDËR NJERËZIMIT** dhe **SHKELJE TË LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS** si vijon:

**FAKTE THEMELORE**

1. Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë gjendet në pjesën jugore të Republikës së Serbisë, një republikë përbërëse e Republikës Federale të Jugosllavisë (tutje "RFJ"). Territori i tashëm i RFJ-së ishte pjesë e ish-Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (tutje "RSFJ"). Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë kufizohet në veri dhe veriperëndim me Republikën e Malit të Zi, gjithashtu republikë përbërëse e RFJ-së. Në jugperëndim, Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë kufizohet me Republikën e Shqipërisë, kurse në jug me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Kryeqyteti i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë është Prishtina.

2. Në vitin 1990, Republika Socialiste e Serbisë shpalli një Kushtetutë të re, me të cilën, ndër të tjera, iu ndryshuan emrat republikës dhe krahinave autonome. Emri i Republikës Socialiste të Serbisë u ndryshua në Republika e Serbisë (të dyja tutje "Serbia"); emri i Krahinës Autonome Socialiste e Kosovës u ndryshua në Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë (të dyja tutje "Kosova"); dhe emri i Krahinës Socialiste Autonome të Vojvodinës u ndryshua në Krahina Autonome e Vojvodinës (tutje "Vojvodina"). Gjatë kësaj periudhe, Republika Socialiste e Malit të Zi ndryshoi emrin në Republika e Malit të Zi (tutje "Mali i Zi").

3. Në vitin 1974, Kushtetuta e re e RSFJ-së parashihte decentralizimin e pushtetit qendror në të gjashtë republikat përbërëse të vendit. Brenda Serbisë, Kosova dhe Vojvodina fituan autonomi të gjerë, duke përfshirë kontrollin e sistemeve të tyre arsimore, të gjykatave dhe të policisë. Fituan gjithashtu kuvendet e tyre dhe u përfaqësuan në Kuvendin, Gjykatën Kushtetuese dhe Kryesinë e RSFJ-së.

4. Në vitin 1981, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë me pjesëmarrje pothuajse të plotë, Kosova kishte përafërsisht 1,585,000 banorë, prej të cilëve 1,227,000 (77 për qind) ishin shqiptarë, ndërsa 210,000 (13 për qind) ishin serbë. Ka në dispozicion vetëm vlerësime për popullsinë Kosovës në vitin 1991, sepse shqiptarët e Kosovës bojkotuan regjistrimin e popullsisë organizuar në atë vit. Sipas vlerësimeve të përgjithshme, Kosova tani ka midis 1.800.000 e 2.100.000 banorë, prej të cilëve rreth 85-90 për qind janë shqiptarë të Kosovës dhe 5-10 për qind janë serbë.

5. Gjatë viteve 80, serbët shprehën shqetësime për diskriminimin e tyre nga qeveria krahinore e udhëhequr nga shqiptarët e Kosovës. Në të njejtën kohë, shqiptarët e Kosovës shprehën shqetësime lidhur me zhvillimin e pakët ekonomik dhe kërkuan liberalizimin politik dhe statusin e republikës për Kosovën. Që nga viti 1981, shqiptarët e Kosovës organizuan demonstrata, që u shtypën nga Ushtria e RSFJ-së dhe forcat policore të Serbisë.

6. Në prill të vitit 1987, **Sllobodan MILLOSHEVIQI**, i cili ishte zgjedhur kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë në vitin 1986, shkoi në Kosovë. Në takime me udhëheqës të serbëve vendës dhe në një fjalim të mbajtur para një turme serbësh, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** përkrahu një program të nacionalizmit serb. Me këtë hap, ai braktisi politikën e partisë dhe të pushtetit e cila, prej themelimit të shtetit nga Josip Broz Tito pas Luftës së Dytë Botërore, kishte kufizuar shprehjen e nacionalizmit në RSFJ. Që atëherë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** shfrytëzoi baticën e nacionalizmit serb për të forcuar pushtetin qendror në RSFJ.

7. Në shtator të vitit 1987, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** dhe përkrahës të tij morën nën kontroll Komitetin Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë. Në vitin 1988, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u rizgjodh kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të

Lidhjes së Komunistëve të Serbisë. Nga kjo pozitë me ndikim, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** pati mundësi që të forconte më tej pushtetin e vet politik.

8. Prej korrikut të vitit 1988 deri në mars 1989 ndodhën në Vojvodinë dhe Mal të Zi një varg demonstratash dhe mitingjesh në përkrahje të politikës së **Sllobodan MILLOSHEVIQIT** – të ashtuquajturit "revolucion antiburokratik." Këto protesta çuan në përmbysjen e qeverive përkatëse krahinore dhe republikane. Qeveritë pasardhëse e përkrahën **Sllobodan MILLOSHEVIQIN** dhe i detyroheshin atij.

9. Në po këtë kohë, brenda Serbisë u shpeshtuan thirrjet për ta vënë Kosovën nën një pushtet më të fortë serb, për ç'gjë u mbajtën shumë demonstrata. Më 17 nëntor 1988, personalitete të larta politike të shqiptarëve të Kosovës u larguan nga udhëheqja krahinore, ndërsa në vend të tyre u emëruan njerëz besnikë ndaj **Sllobodan MILLOSHEVIQIT**. Në fillim të vitit 1989, Kuvendi i Serbisë propozoi ndryshime në Kushtetutën e Serbisë, të cilat do ta zhvishnin Kosovën nga pjesa më e madhe e autonomisë, duke përfshirë kontrollin mbi policinë, politikën arsimore dhe ekonomike, zgjedhjen e gjuhës zyrtare dhe të drejtën e vetos mbi ndryshime të mëtejshme në Kushtetutën e Serbisë. Shqiptarët e Kosovës bënë protesta masive kundër ndryshimeve të propozuara. Duke filluar nga shkurti i vitit 1989, një grevë e minatorëve shqiptarë të Kosovës tendosi gjendjen edhe më shumë.

10. Për shkak të trazirave politike, më 3 mars 1989 Kryesia e RSFJ-së shpalli se gjendja në krahinë ishte keqësuar dhe përbënte një kërcënim ndaj kushtetutës, integritetit dhe sovranitetit të vendit. Qeveria pastaj mori "masa të posaçme," të cilat i dhanë përgjegjësinë për sigurinë publike qeverisë federale, në vend se qeverisë së Serbisë.

11. Më 23 mars 1989, Kuvendi i Kosovës u mblodh në Prishtinë dhe me abstenimin e shumicës së delegatëve të shqiptarëvë të Kosovës, votoi për pranimin e ndryshimeve të propozuara për Kushtetutën. Edhe pa shumicën e duhur të dy të tretave të votave në Kuvend, kryetari i Kuvendit shpalli miratimin e ndryshimeve. Më 28 mars 1989, Kuvendi i Serbisë votoi për të miratuar ndryshimet në Kushtetutë, duke hequr faktikisht autonominë e dhënë me Kushtetutën e vitit 1974.

12. Në kohën e këtyre ndryshimeve në Kosovë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** forcoi më tej pushtetin e vet politik kur u bë kryetar i Serbisë. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i Kryesisë së Serbisë më 8 maj 1989 dhe posti iu konfirmua formalisht më 6 dhjetor 1989.

13. Në fillim të vitit 1990, shqiptarët e Kosovës mbajtën demonstrata masive për të kërkuar heqjen e "masave të posaçme." Në prill të vitit 1990, Kryesia e RSFJ-së i hoqi "masat e posaçme" dhe tërhoqi shumicën e forcave policore, ndërsa Serbia mori përsipër përgjegjësinë për detyra policore në Kosovë.

14. Në korrik të vitit 1990, Kuvendi i Serbisë miratoi vendimin për të pezulluar Kuvendin e Kosovës, pak kohë mbasi që 114 prej 123 delegatëve shqiptarë të Kosovës në këtë Kuvend miratuan një rezolutë jozyrtare, me anë të së cilës Kosova u shpall njësi e barabartë dhe e pavarur brenda RSFJ-së. Në shtator të vitit 1990, shumë prej këtyre delegatëve shqiptarë të Kosovës shpallën kushtetutën e "Republikës së Kosovës." Një vit më vonë, në shtator të vitit 1991, shqiptarët e Kosovës mbajtën një referendum jozyrtar në të cilin shumica dërrmuese votuan për pavarësi. Më 24 maj 1992, shqiptarët e Kosovës mbajtën zgjedhje jozyrtare për kuvendin dhe kryetarin e "Republikës së Kosovës."

15. Më 16 korrik 1990, Lidhja e Komunistëve të Serbisë dhe Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Serbisë u bashkuan për të formuar Partinë Socialiste të Serbisë (SPS). **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i partisë. Si pasardhëse e Lidhjes së Komunistëve, SPS-ja u bë partia politike kryesore në Serbi; **Sllobodan MILLOSHEVIQI**, si kryetar i SPS-së, pati mundësi për të ushtruar pushtet dhe ndikim të konsiderueshëm në shumë degë të qeverisë si dhe të sektorit privat. Edhe **Millan MILLUTINOVIQI** dhe **Nikolla SHAINOVIQI** kanë pasur poste udhëheqëse në SPS: **Nikolla SHAINOVIQI** ishte anëtar i Këshillit Drejtues dhe i Këshillit Ekzekutiv dhe nënkryetar i partisë. **Millan MILLUTINOVIQI** fitoi zgjedhjet për postin e kryetarit të Serbisë si kandidat i SPS-së më 1997.

16. Pas miratimit të Kushtetutës së re të Serbisë më 28 shtator 1990, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i Serbisë në zgjedhje shumëpartiake që u mbajtën më 9 dhe 26 dhjetor 1990. U rizgjodh më 20 dhjetor 1992. Në dhjetor të vitit 1991, **Nikolla SHAINOVIQI** u emërua zëvendëskryeministër i Serbisë.

17. Pas heqjes faktike të autonomisë së Kosovës më 1989, u thelluan ndasitë në gjendjen politike në Kosovë. Në fund të vitit 1990 dhe gjatë vitit 1991, mijëra shqiptarë të Kosovës -- mjekë, arsimtarë, profesorë, punëtorë, policë dhe nëpunës -- u përzunë nga postet e tyre. Gjykatat vendore në Kosovë u hoqën dhe shumë gjykatës u larguan nga puna. U shtua dhuna policore kundër shqiptarëve të Kosovës.

18. Gjatë kësaj periudhe, udhëheqja jozyrtare e shqiptarëve të Kosovës ndiqte politikën e rezistencës qytetare paqësore dhe filloi të vendoste sistemin e institucioneve paralele dhe jozyrtare në sektorët e shëndetësisë dhe të arsimit.

19. Në fund të qershorit të vitit 1991 filloi shpërbërja e RSFJ-së në një sërë luftërash të njëpasnjëshme në Republikën e Sllovenisë (tutje "Sllovenia"), në Republikën e Kroacisë (tutje "Kroacia"), dhe në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës (tutje "Bosnja dhe Hercegovina"). Më 25 qershor 1991 Sllovenia shpalli pavarësinë nga RSFJ-ja, gjë që çoi në shpërthimin e luftës. Një marrëveshje e paqes u arrit më 8 korrik 1991. Kroacia shpalli pavarësinë më 25 qershor 1991, gjë që çoi në luftime midis forcave ushtarake kroate, në një anë, dhe Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ), njësive paramilitare dhe "Armatës së Republikës së Krajinës Serbe", në anën tjetër.

20. Më 6 mars 1992 Bosnja dhe Hercegovina shpalli pavarësinë, gjë që çoi në një luftë të gjerë pas 6 prillit të vitit 1992. Më 27 prill 1992, RSFJ-ja u rikonstituua si RFJ. Atëherë APJ-ja u riformua si Forcat e Armatosura të RFJ-së (tutje "UJ"). Gjatë luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, APJ-ja dhe më vonë UJ-ja luftuan bashkë me "Ushtrinë e Republikës Serbe" kundër forcave ushtarake të qeverisë së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe të "Këshillit Kroat të Mbrojtjes". Luftimet aktive pushuan me nënshkrimin e marrëveshjes së Dejtonit në dhjetor të vitit 1995.

21. Edhe pse **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ishte kryetar i Serbisë gjatë luftërave në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, ai ishte politikani kryesor serb që ushtroi kontroll faktik mbi qeverinë federale si edhe atë republikane. Ai ishte gjithashtu njeriu me të cilin bashkësia ndërkombëtare bëri biseda për një sërë planesh të paqes dhe marrëveshjesh lidhur me këto luftëra.

22. Midis viteve 1991 dhe 1997, si **Millan MILLUTINOVIQI** ashtu dhe **NIKOLLA SHAINOVIQI** mbajtën disa poste të larta brenda qeverive federale dhe republikane dhe vazhduan të bashkëpunojnë ngushtë me **Sllobodan MILLOSHEVIQIN**. Gjatë kësaj periudhe, **Millan MILLUTINOVIQI** punoi në Ministrinë e Punëve të Jashtme të RFJ-

së dhe për një kohë ishte ambasador në Greqi. Më 1995, ai u caktua ministër i Punëve të Jashtme të RFJ-së. Mbeti në këtë post deri më 1997. **Nikolla SHAINOVIQI** ishte kryeministër i Serbisë më 1993 dhe zëvendëskryeministër i RFJ-së më 1994.

23. Në kohën e luftërave në Slloveni, në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, gjendja në Kosovë, ndonëse e tendosur, nuk shpërtheu në dhunën dhe luftimet intensive të sojit që u panë në vende të tjera. Mirëpo, nga mesi i viteve 90, një pjesë e shqiptarëve të Kosovës themeloi një grup, të quajtur *Ushtria Çlirimtare e Kosovës* (UÇK). Ky grup u angazhua për një fushatë kryengritjeje të armatosur, duke bërë rezistencë me dhunë kundër autoriteteve serbe. Në mes të vitit 1996, forcat e UÇK-së filluan sulme drejtuar kryesisht kundër forcave policore të RFJ-së dhe të Serbisë. Pastaj, edhe gjatë tërë vitit 1997, forcat policore të RFJ-së dhe të Serbisë u përgjigjën me aksione të fuqishme kundër bazave dhe përkrahësve të mundshëm të UÇK-së në Kosovë.

24. Pas përfundimit të mandatit si kryetar i Serbisë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i RFJ-së më 15 korrik 1997 dhe u inaugurua në këtë post më 23 korrik 1997. Pastaj u mbajtën zgjedhjet për postin e kryetarit të Serbisë. **Millan MILLUTINOVIQI** mori pjesë në zgjedhje si kandidat i SPS-së dhe u zgjodh kryetar i Serbisë më 21 dhjetor 1997. Në vitet 1996, 1997 dhe 1998, **Nikolla SHAINOVIQI** u riemërua zëvendëskryeministër i RFJ-së. Pjesërisht falë lidhjeve të tij të ngushta me **Millan MILLUTINOVIQIN**, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** mundi të ruante ndikimin e tij mbi qeverinë e Serbisë.

25. Nga fundi i shkurtit të vitit 1998, thellohej konflikti ndërmjet UÇK-së, në një anë, dhe UJ-së, forcave policore të RFJ-së, forcave policore të Serbisë, dhe njësive paramilitare (tutje "forcat e RFJ-së dhe të Serbisë"). Një numër shqiptarësh të Kosovës dhe serbësh të Kosovës u vranë dhe u plagosën gjatë kësaj kohe. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i hynë një fushate granatimi të qyteteve dhe fshatrave të banuara kryesisht nga shqiptarët të Kosovës, me shkatërrime të mëdha të pasurisë dhe dëbime të popullsisë civile nga viset në të cilat vepronte UÇK-ja. Shumë banorë ikën nga ky territor për shkak të luftimeve apo shkatërrimeve, apo u detyruan të shpërnguleshin në vende të tjera brenda Kosovës. Sipas vlerësimeve të Kombëve të Bashkuara, deri në mesin e tetorit të vitit 1998, mbi 298,000 njerëz, apo afër 15 për qind të popullsisë, u zhvendosën brenda Kosovës ose u larguan nga krahina.

26. Në përgjigje ndaj thellimit të konfliktit, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1160 në mars të vitit 1998, "duke dënuar përdorimin e forcës së tepërt nga forcat policore serbe kundër civilëve dhe demonstruesve paqësorë në Kosovë", dhe vendosi embargon e armëve kundër RFJ-së. Gjashtë muaj më vonë, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1199 (1998), e cila theksonte se "keqësimi i gjendjes në Kosovë, Republikën Federale të Jugosllavisë, kërcënon paqen dhe sigurinë në rajon". Këshilli i Sigurimit kërkoi pushimin e luftimeve nga të gjitha palët dhe tërheqjen e "forcave që përdoren për shtypjen e civilëve".

27. Në përpjekje për të ulur tensionet në Kosovë, përfaqësuesit e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) dhe të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) mbajtën bisedime me **Sllobodan MILLOSHEVIQIN** në tetor të vitit 1998. "Marrëveshja për Misionin Verifikues të OSBE-së në Kosovë" u nënshkrua më 16 tetor 1998. Kjo marrëveshje dhe "marrëveshja Klark-Nauman", e cila u nënshkrua nga **Nikolla SHAINOVIQI**, parashikoi tërheqjen e pjesshme të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë nga Kosova, kufizimin e futjes së forcave dhe të pajisjeve të tjera në krahinë, dhe vendosjen e verifikuesve të paarmatosur të OSBE-së.

28. Edhe pse dhjetëra verifikues të OSBE-së u vendosën anembanë Kosovës, luftimet vazhduan. Gjatë kësaj periudhe, verifikuesit ndërkombëtarë dhe organizatat për të drejtat e njeriut dokumentuan një sërë vrasjesh të shqiptarëve të Kosovës. Në një rast të tillë, më 15 janar 1999, 45 shqiptarë të paarmatosur të Kosovës u vranë në fshatin Reçak, në komunën e Shtimjes.

29. Përsëri në përgjigje të konfliktit që po vazhdonte në Kosovë, u organizua një konferencë ndërkombëtare e paqes në Rambuje të Francës, e cila filloi më 7 shkurt 1999. **Nikolla SHAINOVIQI**, zëvendëskryeministër i RFJ-së, ishte anëtar i delegacionit serb në bisedimet e paqes dhe **Millan MILLUTINOVIQI**, kryetar i Serbisë, gjithashtu ishte i pranishëm gjatë negociatave. Shqiptarët e Kosovës u përfaqësuan nga UÇK-ja dhe një delegacion prej udhëheqësve politikë e qytetarë të shqiptarëve të Kosovës. Me gjithë negociatat intensive që zgjatën disa javë, bisedimet dështuan në mesin e marsit të vitit 1999.

30. Dhuna në Kosovë vazhdoi gjatë bisedimeve të paqes në Francë. Në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një sërë ofensivash kundër dhjetëra fshatrave dhe qyteteve të banuara kryesisht nga shqiptarë të Kosovës. Forcat ushtarake të RFJ-së përfshinin njësi të Armatës së Tretë, konkretisht Korpusin e 52-të, të quajtur Korpusi i Prishtinës, me disa brigada dhe regjimente nën komandën e Korpusit të Prishtinës. Shefi i Shtabit të Përgjthshëm të UJ-së, me përgjegjësinë komanduese mbi Armatën e Tretë dhe rrjedhimisht mbi Korpusin e Prishtinës, është **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI**. Komandanti Suprem i UJ-së është **Sllobodan MILLOSHEVIQI**,

31. Forcat policore që marrin pjesë në aksione në Kosovë janë pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, bashkë me disa njësi nga Ministria e Punëve të Brendshme e RFJ-së. Të gjitha forcat policore që janë punësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë apo që punojnë nën drejtimin e kësaj ministrie janë nën komandën e **Vllajko STOJILKOVIQIT**, ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë. Sipas Ligjit të RFJ-së mbi Forcat e Armatosura, këto forca policore të angazhuara në aksione ushtarake gjatë gjendjes së luftës apo kanosjes së afërt të luftës i nënshtrohen komandës së UJ-së, komandantë të së cilës janë **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** dhe **Sllobodan MILLOSHEVIQI**.

32. Para dhjetorit të vitit 1998, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** caktoi **Nikolla SHAINOVIQIN** si përfaqësues të tij për gjendjen në Kosovë. Një sërë diplomatësh dhe zyrtarësh të tjerë ndërkombëtarë, të cilët kishin nevojë të bisedonin me një zyrtar qeveritar rreth ngjarjeve në Kosovë, ishin drejtuar te **Nikolla SHAINOVIQI**. Ai luajti një rol aktiv në negociatat që çuan në themelimin e misionit verifikues të OSBE-së për Kosovën dhe mori pjesë në shumë takime të tjera rreth krizës në Kosovë. Prej janarit të vitit 1999 deri në datën e kësaj aktakuze, **Nikolla SHAINOVIQI** ka marrë përsipër rolin e ndërlidhësit midis **Sllobodan MILLOSHEVIQIT** dhe udhëheqësve të ndryshëm të shqiptarëve të Kosovës.

33. **Nikolla SHAINOVIQI** u ricaktua së voni zëvendëskryeministër i RFJ-së më 20 maj 1998. Rrjedhimisht, ai është anëtar i qeverisë së RFJ-së e cila, ndër detyra dhe përgjegjësi të tjera, përcakton politikën e brendshme dhe të jashtme; zbaton ligjin federal, drejton dhe bashkërendon punën e ministrive federale, dhe organizon përgatitje për mbrojtje.

34. Gjatë ofensivave të tyre, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kanë vepruar bashkërisht, duke u angazhuar në një fushatë të planifikuar dhe të bashkërenduar mirë për të

shkatërruar pasurinë e civilëve shqiptarë të Kosovës. Janë granatuar qytete dhe fshatra; janë djegur shtëpi, ekonomi bujqësore dhe biznese; është shkatërruar pasuria personale. Si pasojë e këtyre aksioneve të planifikuara, qytete, fshatra dhe rajone të tëra janë bërë të pabanueshme për shqiptarë të Kosovës. Përveç kësaj, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kanë përndjekur, poshtëruar dhe degraduar shqiptarët e Kosovës përmes keqtrajtimesh fizike dhe verbale. Shqiptarët e Kosovës gjithashtu u janë nënshtruar vazhdimisht sharjeve, fyerjeve raciste, veprimeve poshtëruese mbi bazë të përkatësisë së tyre etnike dhe fetare; rrahjeve dhe formave të tjera të keqtrajtimit fizik.

35. Dëbimi i jashtëligjshëm dhe transferimi i dhunshëm i mijërave shqiptarëve të Kosovës nga shtëpitë e tyre në Kosovë janë bërë përmes përpjekjesh të planifikuara dhe të bashkërenditura mirë nga udhëheqësit e RFJ-së dhe të Serbisë dhe forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, që të gjithë duke vepruar bashkërisht. Aksione të ngjashme kanë ndodhur gjatë luftërave në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë në vitet 1991-1995. Gjatë këtyre luftërave, forcat ushtarake, paraushtarake dhe policore serbe dëbuan me forcë dhe deportuan popullatën joserbe nga viset nën kontrollin serb në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, duke përdorur të njëjtat metoda të veprimit si në Kosovë në vitin 1999: granatimet me armë të rënda; sulmet e armatosura mbi fshatra; vrasjet masive; shkatërrimin e vendbanimeve joserbe dhe të objekteve kulturore dhe fetare; dhe transferimin e dhunshëm dhe deportimin e popullsive joserbe.

36. Më 24 mars 1999, NATO-ja filloi sulmet ajrore kundër caqeve në RFJ. RFJ-ja shpalli dekrete për kanosjen e afërt të luftës më 23 mars 1999 dhe të gjendjes së luftës më 24 mars 1999. Pas fillimit të sulmeve ajrore, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kanë filluar fushatën e tyre sistematike dhe kanë dëbuar me dhunë qindra mijëra shqiptarë të Kosovës.

37. Përveç dëbimit me dhunë të shqiptarëve të Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë gjithashtu kanë marrë pjesë në një numër vrasjesh të shqiptarëve të Kosovës pas 24 marsit të vitit 1999. Vrasjet e tilla kanë ndodhur në shumë vende, duke përfshirë Bellacërkën, Krushën e Vogël, Krushën e Madhe, Gjakovën, Padalishtën dhe Izbicën, por edhe në vende të tjera.

38. Përgatitja dhe kryerja e fushatës së ndërmarrë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë ishte planifikuar, nxitur, urdhëruar, zbatuar apo në ndonjë mënyrë tjetër ndihmuar nga **Sllobodan MILLOSHEVIQI**, kryetar i RFJ-së; **Millan MILLUTINOVIQI**, kryetar i Serbisë; **Nikolla SHAINOVIQI**, zëvendëskryeministër i RFJ-së; **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI**, shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së; dhe **Vllajko STOJILKOVIQI**, ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë.

39. Deri më 20 maj 1999, më shumë se 740,000 shqiptarë të Kosovës, afër një e treta e popullsisë së Kosovës, u dëbuan nga Kosova. Mendohet se mijëra të tjerë janë zhvendosur brenda vendit. Një numër -- nuk dihet sa -- shqiptarësh të Kosovës janë vrarë në operacione të ndërmarra nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.

## TË AKUZUARIT

40. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** lindi më 20 gusht 1941 në qytetin e Pozharevcit, në Serbinë e sotme. Në vitin 1964 u diplomua në drejtësi në Universitetin e Beogradit dhe filloi karrierë si drejtor dhe bankier. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** mbajti postin e zëvendësdrejtorit dhe pastaj të drejtorit të përgjithshëm në kompaninë e madhe të gazit *Tehnogas* deri në vitin 1978. Pastaj u bë president i bankës *Beogradska Banka*

*(Beobanka)*, njëra prej bankave më të mëdha në RSFJ, dhe mbeti në këtë pozitë deri në 1983.

41. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** filloi karrierën e tij politike në vitin 1983. U bë kryetar i Komitetit të Qytetit të Lidhjes së Komunistëve të Beogradit në 1984. Më 1986 u zgjodh kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe u rizgjodh më 1988. Më 16 korrik 1990, Lidhja e Komunistëve të Serbisë dhe Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Serbisë u bashkuan; partia e re u quajt Partia Socialiste e Serbisë (SPS); **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i saj. Ai ka mbajtur postin e kryetarit të SPS-së deri në datën e kësaj aktakuze.

42. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i Kryesisë së Serbisë më 8 maj 1989 dhe u rizgjodh më 5 dhjetor po atë vit. Pas hyrjes në fuqi të kushtetutës së re të Serbisë më 28 shtator 1990, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh në postin e sapokrijuar të kryetarit të Serbisë në zgjedhje shumëpartiake mbajtur më 9 dhe 26 dhjetor 1990; ai u rizgjodh më 20 dhjetor 1992.

43. Pas dy mandateve si kryetar i Serbisë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i RFJ-së më 15 korrik 1997 dhe filloi nga detyrat zyrtare më 23 korrik 1997. Gjatë tërë periudhës që lidhet me këtë aktakuzë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ka qenë në postin e kryetarit të RFJ-së.

44. **Millan MILLUTINOVIQI** lindi më 19 dhjetor 1942 në Beograd, në Serbinë e sotme. **Millan MILLUTINOVIQI** u diplomua në drejtësi në Universitetin e Beogradit.

45. Gjatë tërë karrierës së tij politike, **Millan MILLUTINOVIQI** ka mbajtur shumë poste të larta qeveritare në Serbi dhe në RFJ. **Millan MILLUTINOVIQI** ishte deputet në Dhomën Shoqëroro-Politike dhe anëtar i Komitetit të Politikës së Jashtme në Kuvendin Federal. Ai ka qenë sekretar për Arsim dhe Shkencë i Serbisë; anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Serbisë; dhe drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Serbisë. **Millan MILLUTINOVIQI** gjithashtu ka shërbyer si ambasador në Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme dhe si ambasador i RFJ-së në Greqi. Ai u emërua ministër i Punëve të Jashtme të RFJ-së më 15 gusht 1995. **Millan MILLUTINOVIQI** është anëtar i SPS-së.

46. Më 21 dhjetor 1997, **Millan MILLUTINOVIQI** u zgjodh kryetar i Serbisë. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Millan MILLUTINOVIQI** ka qenë në postin e kryetarit të Serbisë.

47. **Nikolla SHAINOVIQI** lindi më 7 dhjetor 1948 në Bor, Serbi. Ai u diplomua në Universitetin e Lubjanës në 1977 dhe ka magjistruar në inxhinieri kimike. Ai filloi karrierën e tij politike në komunën e Borit, ku mbajti postin e kryetarit të Kuvendit Komunal të Borit prej vitit 1978 deri më 1982.

48. Gjatë tërë karrierës së tij politike, **Nikolla SHAINOVIQI** ka qenë anëtar aktiv i Lidhjes së Komunistëve dhe i Partisë Socialiste të Serbisë (SPS). Ai ka mbajtur postin e kryetarit të Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve në Bor. Më 25 nëntor 1995, **Nikolla SHAINOVIQI** u zgjodh anëtar i Këshillit Drejtues të SPS-së dhe anëtar i Këshillit Ekzekutiv të saj. Gjithashtu ai u caktua kryetar i komitetit për përgatitjen e Kongresit të Tretë të Rregullt të SPS-së (mbajtur në Beograd më 2-3 mars 1996). Më 2 mars 1996 **Nikolla SHAINOVIQI** u zgjodh si njëri prej disa zëvendëskryetarëve të SPS-së. Mbeti në këtë post deri më 24 prill 1997.

49. **Nikolla SHAINOVIQI** ka mbajtur disa poste në qeveritë e Serbisë dhe të RFJ-së. Më 1989 ai ishte anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Serbisë dhe sekretar për Industri, Energjetikë dhe Teknologji. U emërua ministër për Miniera dhe Energjetikë i Serbisë më 11 shkurt 1991 dhe përsëri më 23 dhjetor 1991. Më 23 dhjetor 1991 u emërua gjithashtu zëvendëskryeministër i Serbisë. **NIKOLLA SHAINOVIQI** u emërua ministër i Ekonomisë i RFJ-së më 14 korrik 1992 dhe përsëri më 11 shtator 1992. Ai dha dorëheqje prej këtij posti më 29 nëntor 1992. Më 10 shkurt 1993, **Nikolla SHAINOVIQI** u zgjodh kryeministër i Serbisë.

50. Më 22 shkurt 1994, **Nikolla SHAINOVIQI** u emërua zëvendëskryeministër i RFJ-së. Ai u riemërua në këtë post në tri qeveri me radhë: më 12 qershor 1996, më 20 mars 1997 dhe më 20 maj 1998. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** caktoi **Nikolla SHAINOVIQIN** si përfaqësues të tij për gjendjen në Kosovë. **Nikolla SHAINOVIQI** kryesoi komisionin për bashkëpunim me Misionin Verifikues të OSBE-së në Kosovë dhe ishte anëtar zyrtar i delegacionit serb në bisedime për paqe në Rambuje në shkurt të vitit 1999. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Nikolla SHAINOVIQI** ka qenë në postin e zëvendëskryeministrit të RFJ-së.

51. **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** lindi më 1 qershor 1941 në fshatin Ravni afër Uzhicës, në Serbinë e sotme. Më 1958 ai mbaroi Shkollën e Këmbësorisë për Nënoficerë dhe më 1964 mbaroi Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore. Më 1985 **Dragolub OJDANIQI** u diplomua në Akademinë e Shtabit të Komandës dhe në Fakultetin e Mbrojtjes Popullore me titullin e magjistrit të shkencave ushtarake. Në një kohë shërbeu si sekretar i Lidhjes së Komunistëve të Korpusit të 52-të të Armatës Popullore Jugosllave (APJ), paraardhësi i Korpusit të 52-të të UJ-së, i cili tani vepron në Kosovë.

52. Më 1992, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** ishte zëvendëskomandant i Korpusit të 37-të të APJ-së, më vonë të UJ-së, me bazë në Uzhicë, Serbi. Ai mori gradën e gjeneral majorit më 20 prill 1992 dhe u bë komandant i Korpusit të Uzhicës. Nën komandën e tij, Korpusi i Uzhicës mori pjesë në veprime luftarake në Bosnjën lindore gjatë luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në vitet 1993-1994, **Dragolub OJDANIQI** shërbeu si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Parë të RFJ-së. Ai ishte komandant i Armatës së Parë në vitet 1994-1996. Më 1996 u bë zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së. Me 26 nëntor 1998 **Sllobodan MILLOSHEVIQI** emëroi **Dragolub OJDANIQIN** shef të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së në vend të Momçillo Perishiqit. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Dragolub OJDANIQI** ka qenë në postin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së.

53. **Vllajko STOJILKOVIQI** lindi në Mala Kërsna në Serbi. U diplomua në drejtësi në Universitetin e Beogradit dhe pastaj u punësua në gjykatën komunale. Më vonë u bë drejtor i Sekretariatit Ndërkomunal të Punëve të Brendshme në Pozharevc. **Vllajko STOJILKOVIQI** ka shërbyer si drejtor i kompanisë PIK në Pozharevc, zëvendëskryetar dhe kryetar i Këshillit Ekonomik të Jugosllavisë, si dhe kryetar i Këshillit Ekonomik të Serbisë.

54. Para prillit të vitit 1997, **Vllajko STOJILKOVIQI** u bë zëvendëskryeministër i qeverisë së Serbisë dhe ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë. Më 24 mars 1998, Kuvendi i Serbisë zgjodhi një qeveri të re dhe **Vllajko STOJILKOVIQI** u emërua ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë. Ai është gjithashtu anëtar i Këshillit Drejtues të SPS-së. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Vllajko STOJILKOVIQI** ka qenë në postin e ministrit të Punëve të Brendshme.

## AUTORITETET EPRORE

55. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** u zgjodh kryetar i RFJ-së më 15 korrik 1997 dhe filloi detyrën më 23 korrik 1997. Ai ka mbetur kryetar deri në datën e kësaj aktakuze.

56. Si kryetar i RFJ-së, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** vepron edhe si kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes të RFJ-së. Këshilli Suprem i Mbrojtjes përbëhet nga kryetari i RFJ-së dhe kryetarët e republikave anëtare, Serbisë dhe Mali të Zi. Këshilli Suprem i Mbrojtjes vendos për Planin e Mbrojtjes Kombëtare dhe shpall vendime lidhur me UJ-në. Si kryetar i RFJ-së, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ka kompetencë "për të urdhëruar zbatimin e Planit Kombëtar të Mbrojtjes" dhe komandon UJ-në në luftë dhe në paqe në përputhje me vendimet e Këshillit Suprem të Mbrojtjes. **Sllobodan MILLOSHEVIQI**, si komandant suprem i UJ-së, kryen këto detyra nëpërmjet "komandimeve, urdhërave dhe vendimeve".

57. Sipas Ligjit mbi Forcat e Armatosura të Jugosllavisë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** si komandant suprem i UJ-së gjithashtu ushtron autoritet komandues mbi njësitë policore republikane dhe federale, të cilat janë vënë në vartësi të UJ-së në gjendje lufte apo në gjendje të kanosjes së afërt të luftës. Deklarata e kanosjes së afërt të luftës u shpall më 23 mars 1999, ndërsa ajo e gjendjes së luftës më 24 mars 1999.

58. Përpos kompetencave të tij *de jure*, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ushtron kontroll të gjerë *de facto* mbi shumë institucione me rëndësi thelbësore për kryerjen e krimeve që përmenden në këtë aktakuzë, apo për përfshirjen në këto krime. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ushtron kontroll të gjerë *de facto* mbi institucione federale që formalisht janë nën kompetencat e Kuvendit apo të Qeverisë së RFJ-së. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** gjithashtu ushtron kontroll *de facto* mbi funksione dhe institucione që formalisht janë nën kompetencat e Serbisë dhe të krahinave autonome, duke përfshirë policinë e Serbisë. **Sllobodan MILLOSHEVIQI** gjithashtu ushtron kontroll *de facto* mbi shumë lëmenj të jetës politike dhe ekonomike të RFJ-së, veçanërisht mbi mjetet e informimit. Prej vitit 1986 deri në fillim të viteve 90, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** dalngadalë mori nën kontroll *de facto* këto institucione federale, republikane dhe krahinore. Ai vazhdon të ushtrojë këtë kontroll *de facto* deri në ditën e sotme.

59. Kontrolli *de facto* i **Sllobodan MILLOSHEVIQIT** mbi organet e Serbisë, të RSFJ-së dhe të RFJ-së dhe mbi organe të tjera shtetërore rrjedh pjesërisht nga udhëheqja prej tij e të dyja partive politike kryesore të cilat kanë qenë në pushtet në Serbi prej vitit 1986 dhe në RFJ prej vitit 1992. Prej vitit 1986 deri më 1990 ai ishte kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, atëbotë partia në pushtet në Serbi. Në vitin 1990, ai u zgjodh Kryetar i Partisë Socialiste të Serbisë (SPS), partia pasardhëse e Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe të Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës së Serbisë. Prej asaj kohe, SPS-ja ka qenë partia kryesore në pushtet në Serbi dhe në RFJ. Gjatë periudhës së tij si kryetar i Serbisë, prej 1990 deri në 1997, dhe si kryetar i RFJ-së prej vitit 1997 deri më sot, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ka qenë edhe udhëheqës i SPS-së.

60. Të paktën që nga tetori i vitit 1988, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ka ushtruar kontroll *de facto* mbi institucionet në pushtet dhe ato qeveritare të Serbisë, duke përfshirë policinë. Të paktën që nga tetori i vitit 1988, ai ka ushtruar kontroll *de facto* mbi të dyja krahinat autonome të Serbisë – Kosovë dhe Vojvodinë – dhe mbi përfaqësimin e tyre në organet federale të RSFJ-së dhe RFJ-së. Të paktën që nga tetori i

vitit 1988 deri në mesin e vitit 1998, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ka ushtruar gjithashtu kontroll *de facto* mbi institucionet në pushtet dhe ato qeveritare të Malit të Zi, duke përfshirë përfaqësimin e Malit të Zi në të gjitha organet federale të RSFJ-së dhe të RFJ-së,

61. Prej vitit 1989, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** ka qenë bashkëbiseduesi kryesor i bashkësisë ndërkombëtare në negociata, takime, dhe konferenca të rëndësishme ndërkombëtare. Me të janë arritur marrëveshjet ndërkombëtare të cilat më vonë janë zbatuar brenda Serbisë, RSFJ-së dhe gjetkë në territorin e ish-RSFJ-së. Ndër konferencat dhe negociatat ndërkombëtare në të cilat përfaqësues kryesor i RSFJ-së dhe RFJ-së ka qenë **Sllobodan MILLOSHEVIQI** janë: Konferenca e Hagës më 1991; negociatat e Parisit në mars 1993; Konferenca Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në janar 1993; negociatat për planin e paqes Vens-Ouen prej janarit deri në maj 1993; bisedimet për paqe në Gjenevë në verën e vitit 1993; mbledhja e Grupit të Kontaktit në qershor 1994; negociatat për një armëpushim në Bosnjë dhe Hercegovinë prej 9 deri më 14 shtator 1995; negociatat për t'u dhënë fund bombardimeve të NATO-s në Bosnjë dhe Hercegovinë prej 14 deri më 20 shtator 1995; dhe negociatat për paqe në Dejton në nëntor të vitit 1995.

62. Si kryetar i RFJ-së, komandant suprem i UJ-së, kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes dhe në bazë të autoritetit të tij *de facto*, **Sllobodan MILLOSHEVIQI** mban përgjegjësi për veprimet e vartësve të vet brenda UJ-së dhe në çdo forcë policore, qoftë federale apo republikane, e cila ka kryer krimet e përfshira në këtë aktakuzë në krahinën e Kosovës prej janarit të vitit 1999.

63. **Millan MILLUTINOVIQI** u zgjodh kryetar i Serbisë më 21 dhjetor 1997 dhe vazhdon të jetë kryetar në datën e kësaj aktakuze. Si kryetar i Serbisë, **Millan MILLUTINOVIQI** është kryetar shteti. Ai përfaqëson Serbinë dhe udhëheq marrëdhëniet e Serbisë me shtete të huaja dhe organizata ndërkombëtare. Ai organizon përgatitjet për mbrojtjen e Serbisë.

64. Si kryetar i Serbisë, **Millan MILLUTINOVIQI** është anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes të RFJ-së dhe merr pjesë në vendime lidhur me përdorimin e UJ-së.

65. Si kryetar i Serbisë, **Millan MILLUTINOVIQI**, bashkë me Kuvendin, ka kompetenca për të kërkuar raporte edhe nga qeveria e Serbisë, lidhur me çështje nën juridiksionin e saj, dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me veprime të saja dhe gjendjen e sigurisë në Serbi. Si kryetar i Serbisë, **Millan MILLUTINOVIQI** ka kompetenca për të shpërndarë Kuvendin dhe qeverinë bashkë me të, "sipas propozimit të qeverisë dhe me arsye të justifikuara," edhe pse kjo kompetencë ekziston vetëm në kohën e paqes.

66. Me shpalljen e gjendjes së luftës apo të kanosjes së afërt të luftës, **Millan MILLUTINOVIQI** si kryetar i Serbisë mund të marrë masat që janë zakonisht nën kompetencat e Kuvendit, duke përfshirë miratimin e ligjeve; këto masa mund të përfshijnë riorganizimin e qeverisë dhe të ministrive si edhe kufizimin e disa të drejtave dhe lirive.

67. Përpos kompetencave të tij *de jure*, **Millan MILLUTINOVIQI** ushtron ndikim apo kontroll të gjerë *de facto* mbi shumë institucione me rëndësi thelbësore për kryerjen e krimeve që përmenden në këtë aktakuzë, apo janë të përfshira në këto krime. **Millan MILLUTINOVIQI** ushtron ndikim apo kontroll *de facto* mbi funksione dhe

institucione që formalisht janë nën kompetencat e qeverisë dhe Kuvendit të Serbisë dhe të krahinave autonome të saj, duke përfshire ndër të tjera policinë e Serbisë.

68. Prej vitit **Millan MILLUTINOVIQI** ka qenë një nga bashkëbiseduesit kryesorë të bashkësisë ndërkombëtare në negociata, takime dhe konferenca të rëndësishme ndërkombëtare. Ndër konferencat dhe negociatat ndërkombëtare në të cilat **Millan MILLUTINOVIQI** ka qenë ndër perfaqësuesit kryesorë të RFJ-së janë: negociatat paraprake për një armëpushim në Bosnjë dhe Hercegovinë prej 15 deri më 21 gusht 1995; takimet e Gjenevës lidhur me armëpushimin e Bosnjës më 7 shtator 1995; negociatat e mëtejshme për një armëpushim në Bosnjë dhe Hercegovinë prej 9 deri më 14 shtator 1995; negociatat për t'u dhënë fund bombardimeve të NATO-s në Bosnjë dhe Hercegovinë prej 14 deri në 20 shtator 1995; dhe negociatat e paqes në Dejton në nëntor 1995. **Millan MILLUTINOVIQI** gjithashtu ka qenë i pranishëm në negociatat e Rambujesë në shkurt të vitit 1999.

69. Si kryetar i Serbisë dhe anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtes dhe në bazë të kompetencave të tij *de facto*, **Millan MILLUTINOVIQI** mban përgjegjësi për veprimet e të gjithë vartësve të tij brenda UJ-së dhe të të gjitha forcave policore që kanë kryer krimet të përfshira në këtë aktakuzë që nga janari i vitit 1999 brenda krahinës së Kosovës.

70. **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së më 26 nëntor 1998. Ai mbetet në këtë post në datën e kësaj aktakuze. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** komandon, urdhëron, udhëzon, rregullon dhe në mënyra të tjera drejton UJ-në, në bazë të akteve të nxjerra nga kryetari i RFJ-së dhe sipas nevojës për komandimin e UJ-së.

71. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** përcakton organizimin, planin e zhvillimit dhe formimin e komandave, njësive dhe institucioneve të UJ-së, në përputhje me karakterin dhe nevojat e UJ-së dhe në bazë të akteve të nxjerra nga kryetari i RFJ-së.

72. Me autoritetin e pozitës së tij, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** gjithashtu cakton planin për rekrutimin dhe plotësimin e posteve të lira në UJ dhe përndarjen e rekrutëve brenda saj; lëshon rregullore që kanë të bëjnë me stërvitjen e UJ-së; përcakton planin arsimor dhe përgatitjen e lartë të oficerëve ushtarakë profesionalë dhe rezervistë; dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj.

73. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI --** apo oficerë të tjerë të cilëve u ka dhënë autorizim – cakton oficerë, nënoficerë dhe ushtarë në detyrë. Ai gradon nënoficerë, oficerë rezervistë dhe oficerë deri në rangun e kolonelit. **Gjeneralkoloneli Dragoljub OJDANIQI** gjithashtu emëron kryetarë të gjyqeve, gjykatës, prokurorë dhe zëvendës dhe sekretarë të tyre, nëpër gjyqe disiplinore ushtarake.

74. **Gjeneralkoloneli Dragoljub OJDANIQI** kryen përgatitje për thirrje në ushtri të qytetarëve dhe mobilizimin e UJ-së; ai bashkëpunon me Ministritë e Punëve të Brendshme të RFJ-së dhe Serbisë dhe me Ministrinë e Mbrojtjes të RFJ-së, duke mobilizuar organet dhe njësitë e Ministrisë së Punëve të Brendshme; mbikëqyr dhe propozon masa për të korrigjuar probleme që hasen gjatë këtij mobilizimi dhe informon qeverinë e RFJ-së dhe Këshillin Suprem të Mbrojtjes rreth zbatimit të tij.

75. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI** mban përgjegjësi për veprimet e vartësve të vet brenda UJ-së dhe për veprimet e çdo force policore federale apo republikane që është vënë në vartësinë e UJ-së dhe e cila ka kryer krime në krahinën e Kosovës prej janarit të vitit 1999.

76. **Vllajko STOJILKOVIQI** u emërua ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë më 24 mars 1998. Si titullar i një ministrie të qeverisë serbe, **Vllajko STOJILKOVIQI** mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe të akteve të përgjithshme të nxjerra nga Kuvendi, qeveria, apo kryetari i Serbisë.

77. Si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë, **Vllajko STOJILKOVIQI** drejton punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe personelin e saj. Ai përcakton strukturën, kompetencat dhe fushën e veprimit të njësive të organizuara brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ai ka kompetenca për të thirrur anëtarët e korpusit rezervist të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të kryer detyrat në kohën e paqes dhe për të parandaluar veprime që kërcënojnë sigurinë e Serbisë. Urdhërat të cilat ai dhe oficerët e lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme i japin personelit të Ministrisë së Brendshme janë të detyrueshme, përveç në ato raste kur përbëjnë një veprim kriminal.

78. Si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë, **Vllajko STOJILKOVIQI** ka kompentencat për të rishikuar vendimet dhe veprimet e personelit të Ministrisë. Ai shqyrton ankesa kundër vendimeve të marra në instancën e parë nga shefi i një njësie të organizuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ai ka gjithashtu kompetenca për të vendosur për ankesat e individëve që mbahen në arrest nga policia.

79. Më 8 prill 1999, kompetencat e **Vllajko STOJILKOVIQIT** si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë u zgjeruan për të përfshirë transferimin e personelit të Ministrisë në detyra të ndryshme brenda Ministrisë për sa kohë që të jetë e nevojshme.

80. Si ministër i Punëve të Nrendshme të Serbisë, **Vllajko STOJILKOVIQI** mban përgjegjësi për ruajtjen e ligjit dhe rendit në Serbi. Si ministër i Punëve të Brendshme, ai mban përgjegjësi për veprimet e vartësve të tij brenda forcave policore të Ministrisë së Brendshme të Serbisë që kanë kryer krime në krahinën e Kosovës prej janarit të vitit 1999.

## AKUZA TË PËRGJITHSHME

81. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë ka ekzistuar gjendje e konfliktit të armatosur në Kosovë, RFJ.

82. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet që kualifikohen si krime kundër njerëzimit ishin pjesë të një sulmi të gjerë dhe sistematik kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës në RFJ.

83. Secili prej të akuzuarve mban përgjegjësi individuale për krimet për të cilat është akuzuar në këtë aktakuzë, në bazë të Nenit 7 (1) të Statutit të Tribunalit. Përgjegjësia penale individuale përfshin kryerjen, planifikimin, nxitjen, urdhërimin apo ndihmesën në planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e çfarëdo krimi të përmendur në Nenet 2 deri në 5 të Statutit të Tribunalit.

84. Për aq sa ka pushtet ose kontroll mbi UJ-në, mbi njësitë policore dhe njësi të tjera apo individë që janë vënë në vartësinë e komandës së UJ-së në Kosovë, **Sllobodan MILLOSHEVIQI**, si kryetar i RFJ-së, komandant suprem i UJ-së dhe kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes gjithashtu, ose alternativisht, mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve, duke përfshirë anëtarët e UJ-së dhe personelin e lartpërmendur të Ministrive të Mbrojtjes të RFJ-së dhe të Serbisë, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit.

85. Për aq sa ka pushtet ose kontroll mbi njësitë policore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të UJ-së, ose njësitë policore, njësi të tjera ose individë që janë vënë në vartësinë e komandës së UJ-së në Kosovë, **Millan MILLUTINOVIQI**, si kryetar i Serbisë dhe anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes gjithashtu, ose alternativisht, mban përgjegjësi penale për veprimet e vartësve, duke përfshirë personelin e lartpërmendur të Ministrisë së Mbrojtjes të Serbisë, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit.

86. Për aq sa ka pushtet ose kontroll mbi UJ-në, njësitë policore dhe njësi të tjera apo individë që janë vënë në vartësinë e komandës së UJ-së në Kosovë, **Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI**, si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së gjithashtu, ose alternativisht, mban përgjegjësi kriminale për veprimet e vartësve, duke përfshirë anëtarët e UJ-së dhe personelin e lartpërmendur të Ministrive të Mbrojtjes të Serbisë dhe të RFJ-së, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit.

87. Për aq sa ka pushtet ose kontroll mbi personelin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke përfshirë çdo njësi tjetër policore të rregullt apo të mobilizuar, **Vllajko STOJILKOVIQI**, si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë, gjithashtu ose alternativisht mban përgjegjësi kriminale për veprimet e vartësve, duke përfshirë anëtarët e UJ-së dhe personelin e lartpërmendur të Ministrive të Mbrojtjes të RFJ-së dhe të Serbisë, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit.

88. Një epror mban përgjegjësi për veprimet e vartës-it/ve në qoftë se ka ditur apo ka pasur arsye të dinte se vartësi/-t ishte/ishin gati për të kryer veprime të tilla apo i kishte/kishin kryer dhe eprori nuk ka marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprime të tilla, apo për të ndëshkuar ata që i kanë kryer.

89. Akuzat e përgjithshme të përfshira në paragrafet 81 deri në 88 ngriten sërish dhe përfshihen në secilën nga akuzat e poshtëshënuara.

# AKUZAT

### PIKAT 1-4

### KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT

### SHKELJET E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS

90. Duke filluar nga janari i vitit 1999 deri në datën e kësaj aktakuze, **Sllobodan MILLOSHEVIQI**; **Millan MILLUTINOVIQI, Nikolla SHAINOVIQI, Dragolub OJDANIQI** dhe **Vllajko STOJILKOVIQI** kanë planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer, apo ndihmuar në ndonjë mënyrë tjetër, një fushatë terrori dhe dhune kundër civilëve shqiptarë të Kosovës që jetojnë në Kosovë, në RFJ.

91. Fushata e terrorit dhe dhuna e drejtuar kundër popullsisë shqiptare të Kosovës është kryer nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë duke vepruar nën drejtimin dhe me nxitjen, apo përkrahjen e **Sllobodan MILLOSHEVIQIT, Millan MILLUTINOVIQIT, Nikolla SHAINOVIQIT, Dragolub OJDANIQIT** dhe **Vllajko STOJILKOVIQIT**. Veprimet kundër shqiptarëve të Kosovës janë ndërmarrë me qëllim që të largohet nga Kosova një pjesë e konsiderueshme e popullatës shqiptare të Kosovës në përpjekje për të siguruar kontroll të mëtejshëm serb mbi krahinën. Për të arritur këtë qëllim, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar në bashkëpunim, kanë ndërmarrë veprime të përgatitura dhe të bashkërenduara mirë, të përshkruara në paragrafet 92 deri në 98 më poshtë.

92. Në mënyrë sistematike, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kanë dëbuar me dhunë dhe kanë zhvendosur brenda vendit qindra mijëra shqiptarë të Kosovës nga shtëpitë e tyre në mbarë krahinën e Kosovës. Për të lehtësuar këto dëbime dhe zhvendosje, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë qëllimisht kanë krijuar një atmosferë frike dhe shtypjeje me anë të forcës, me kërcënime për përdorimin e forcës dhe me akte dhune.

93. Anembanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kanë plaçkitur pasurinë vetjake dhe komerciale të shqiptarëve të Kosovës të nxjerrë nga shtëpitë e tyre. Policët, ushtarët dhe oficerët ushtarakë u kanë plaçkitur para dhe sende me vlerë shqiptarëve të Kosovës me anë të bastisjeve masive, kërcënimeve të përdorimit të forcës dhe të veprimeve të dhunshme. Zyrtarët në postat kufitare të RFJ-së kanë vjedhur automjete personale dhe pasuri të tjera prej shqiptarëve të Kosovës që dëboheshin nga krahina.

94. Anembanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kanë ndërmarrë një fushatë sistematike për të shkatërruar pasurinë e civilëve shqiptarë të Kosovës. Kjo fushatë është kryer me anë të granatimit intensiv të qyteteve dhe fshatrave; me djegie të shtëpive, të fermave dhe të bizneseve; si dhe me shkatërrim të pasurisë personale. Si pasojë e këtyre veprimeve të bashkërenduara, fshatra, qytete dhe rajone të tëra janë bërë të pabanueshme për shqiptarë të Kosovës.

95. Anembanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në mënyrë sistematike kanë përndjekur, poshtëruar dhe fyer civilë shqiptarë të Kosovës me anë të keqtrajtimeve fizike dhe verbale. Policët, ushtarët dhe oficerët ushtarakë i kanë shqiptarët e Kosovës

objekt fyerjesh, ofendimesh raciste, veprimesh poshtëruese, rrahjesh dhe formash të tjera të keqtrajtimeve fizike mbi bazë të përkatësisë së tyre kombëtare, fetare dhe politike.

96. Anembanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në mënyrë sistematike kanë konfiskuar dhe shkatërruar dokumente personale të identifikimit dhe targat e automjeteve të shqiptarëve të Kosovës. Derisa shqiptarët e Kosovës po dëboheshin nga shtëpitë dhe drejtoheshin drejt kufijve të Kosovës, kërkoheshin që të dorëzonin letërnjoftimet në pika të veçanta gjatë rrugës për në kufi dhe në vendkalimet kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Këto veprime janë bërë me qëllim për të fshirë çdo gjurmë të pranisë së shqiptarëve kosovarë në Kosovë dhe për t'u mohuar të drejtën për t'u kthyer në shtëpitë e tyre.

97. Duke filluar më 1 janar 1999 apo rreth kësaj dite deri në datën e kësaj aktakuze, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo përkrahjen e **Sllobodan MILLOSHEVIQIT, Millan MILLUTINOVIQIT, Nikolla SHAINOVIQIT**, **Dragolub OJDANIQIT** dhe **Vllajko STOJILKOVIQIT** kanë kryer veprimet e parashtruara në paragrafet 92 deri në 96, duke shkaktuar deportimin e dhunshëm të rreth 740,000 shqiptarëve civilë të Kosovës. Këto veprime janë ndërmarrë në të gjitha viset e Kosovës dhe këto metoda dhe mënyra janë përdorur anembanë krahinës, duke përfshirë këto komuna:

a. Gjakovë: Më 2 prill 1999 apo rreth kësaj dite, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të detyronin banorët e Gjakovës të largoheshin nga qyteti. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shpërndaheshin nëpër qytet dhe shkonin shtëpi për shtëpi, duke urdhëruar shqiptarët e Kosovës të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Në disa raste, janë vrarë njerëz dhe shumica e njerëzve është kërcënuar me vdekje. Shumë shtëpi dhe dyqane, pronë të shqiptarëve të Kosovës, janë djegur, kurse ato që ishin pronë të serbëve janë ruajtur. Gjatë periudhës prej 2 deri më 4 prill 1999, mijëra shqiptarë të Kosovës, banorë të Gjakovës dhe të fshatrave përreth, iu bashkuan një kolone të gjatë njerëzish në këmbë apo me vetura, kamionë dhe traktorë, dhe shkuan në kufirin me Shqipërinë. Forcat e FRJ-së dhe të Serbisë i drejtuan të ikurit në rrugë të caktuara më parë. Në postblloqe policore gjatë rrugës, ljetërnjoftimet dhe targat e makinave iu konfiskuan shumicës së shqiptarëve të Kosovës. Në disa raste, kamionët e Ushtrisë Jugosllave janë përdorur për të çuar njerëz deri në kufirin me Shqipërinë.

b. Gjilan: Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kanë hyrë në fshatin Përlepnicë më 6 prill 1999 apo rreth kësaj dite dhe u kanë dhënë urdhër banorëve që të largoheshin duke thënë se fshati do të minohej të nesërmen. Banorët u larguan dhe u përpoqën të hynin në një fshat tjetër, por i ktheu policia. Më 13 prill 1999, banorët e Përlepnicës përsëri u lajmëruan se fshati duhej të zbrazej deri të nesërmen. Në mëngjesin e të nesërmes, banorët shqiptarë të Kosovës u larguan në një kolonë prej afro 500 mjetesh transporti dhe ia mësynë kufirit me Maqedoninë. Pak pas largimit të banorëve, shtëpive në Përlepnicë iu vu zjarri. Shqiptarë të Kosovës në fshatra të tjera në komunën e Gjilanit gjithashtu u nxorën nga shtëpitë e tyre dhe u detyruan t'i bashkoheshin një kolone tjetër deri në kufirin me Maqedoninë. Gjatë udhëtimit, disa meshkuj janë marrë nga kolona dhe janë vrarë buzë rrugës. Shqiptarëve të Kosovës iu morën ljetërnjoftimet kur arritën në kufi.

c. Mitrovicë: Në fund të marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të lëviznin sistematikisht nëpër qytetin e Mitrovicës. Ata hynin nëpër shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës dhe urdhëronin banorët që t'i lëshonin menjëherë shtëpitë dhe të shkonin në stacionin e autobusëve. Disa shtëpive u është vënë zjarri,

kështuqë banorët u detyruan të iknin në lagje të tjera të qytetit. Gjatë një periudhe dyjavore, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vazhduan të dëbonin banorët shqiptarë kosovarë të qytetit. Në këtë kohë, objektet që ishin pronë e shqiptarëve të Kosovës u shkatërruan dhe shqiptarëve kosovarë u janë plaçkitur të holla, automjete dhe sende të tjera me vlerë. Metoda të ngjashme janë zbatuar në fshatrat e tjera të komunës së Mitrovicës: shqiptarë të Kosovës u nxorën nga shtëpitë dhe pastaj fshatrat e tyre u shkatërruan nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Banorët shqiptarë kosovarë të kësaj komune u detyruan t'u bashkoheshin kolonave drejt kufirit me Shqipërinë. Gjatë rrugës për në kufi, ushtarë serbë, policë dhe oficerë ushtarakë u plaçkitën artikuj me vlerë dhe ua konfiskuan letërnjoftimet.

d. Rahovec: Në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Celinë me tanke dhe autoblinda. Pasi granatuan fshatin, trupat hynë në fshat dhe sistematikisht plaçkitën çdo artikull me vlerë nga shtëpitë. Shumica e fshatarëve shqiptarë të Kosovës kishin ikur në një pyll të afërt para ardhjes së ushtrisë dhe policisë. Më 28 mars, një numër policësh serbë detyruan mijëra njerëz që ishin strehuar në pyll të dilnin prej aty. Civilët u detyruan të marshonin deri në një fshat të afërt, ku u ndanë burrat nga gratë. Meshkujt u rrahën, u plaçkitën, dhe atyre iu morën të gjitha letërnjoftimet. Meshkujt pastaj u detyruan të shkonin në këmbë në Prizren dhe pastaj të shkonin në kufirin me Shqipërinë.

Më 25 mars 1999, një grup i madh shqiptarësh të Kosovës shkuan në një mal afër fshatit Nagafc, gjithashtu në komunën e Rahovecit, duke kërkuar shpëtim prej sulmeve mbi fshatrat përreth. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i rrethuan dhe të nesërmen i urdhëruan 8,000 njerëzit që kishin kërkuar strehim në mal të largoheshin. Shqiptarët e Kosovës u detyruan të shkonin në një shkollë aty afër dhe pastaj u shpërndanë me forcë nëpër fshatrat përreth. Pas tri apo katër ditësh, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshatra, shkuan shtëpi për shtëpi dhe urdhëruan njerëzit të dilnin jashtë. Më në fund, këta njerëz u kthyen me forcë në shtëpi dhe iu dha urdhëri që të mos dilnin. Ata për të cilët nuk kishte vend nëpër shtëpi u detyruan të rrinin në vetura dhe në traktorët që ishin parkuar aty afër. Më 2 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të granatonin fshatrat, duke vrarë një numër njerëzish që ishin duke fjetur nëpër traktorë dhe vetura. Ata që mbetën gjallë ia mësynë kufirit me Shqipërinë. Tek kalonin nëpër fshatra të tjera të shkatërruara të shqiptarëve të Kosovës, ushtarët serbë i ngacmonin. Kur arritën në kufi, fshatarëve iu morën të gjitha letërnjoftimet.

e. Pejë: Më 27 dhe 28 mars 1999, në qytetin e Pejës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin shtëpi për shtëpi duke detyruar shqiptarë të Kosovës të largoheshin. Disa shtëpive iu vu zjarri dhe disa njerëz u pushkatuan. Ushtarë dhe policë u vendosën në çdo rrugë, duke i drejtuar shqiptarët e Kosovës drejt qendrës së qytetit. Kur erdhën njerëzit në qendrën e qytetit, ata pa vetura apo mjete transporti u detyruan të hypnin nëpër autobusë apo kamionë dhe u çuan në qytetin e Prizrenit. Në hyrje të qytetit të Prizrenit, shqiptarët e Kosovës u detyruan të zbritnin prej autobusëve dhe të ecnin rreth 40 kilometra deri në kufirin me Shqipërinë, ku u urdhëruan t'u dorëzonin letërnjoftimet policëve serbë.

f. Prishtinë: Më 1 prill 1999 apo rreth kësaj date, policët serbë shkonin në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës në qytetin e Prishtinës dhe i detyronin banorët që të largoheshin brenda pak minutash. Gjatë këtyre dëbimeve, një numër njerëzish janë vrarë. Shumë prej të dëbuarve shkuan drejt në stacionin e trenave, derisa të tjerët kërkuan strehim në lagje të tjera në afërsi. Qindra shqiptarë etnikë, të cilëve policët serbë ua tregonin udhën në çdo udhëkryq, u mblodhën në stacionin e

trenave dhe pastaj u futën në trena dhe në autobusë të stërmbushur pas një pritjeje të gjatë, gjatë së cilës nuk u është dhënë ujë apo ushqim. Ata në tren u çuan deri në Han të Elezit, fshat afër kufirit me Maqedoninë. Gjatë udhëtimit me tren, shumë njerëzve u janë marrë letërnjoftimet. Pasi zbritën nga treni, shqiptarëve të Kosovës policia serbe u tha të ecnin nëpër binarë deri në Maqedoni, sepse toka përreth ishte e minuar. Ata që kërkonin të fshiheshin në Prishtinë u dëbuan në një mënyrë të ngjashme disa ditë më vonë.

Gjatë kësaj periudhe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynin në fshatrat e komunës së Prishtinës, ku ata rrahën dhe vranë shumë shqiptarë të Kosovës, duke ua plaçkitur të hollat dhe pasurinë dhe duke ua djegur shtëpitë. Shumë prej fshatarëve u çuan me kamion në Gllogoc të komunës së Lipjanit. Prej andej u transportuan në Han të Elezit me tren dhe kanë ecur deri në kufirin me Maqedoninë. Të tjerët, pasi arritën në qytetin e Ferizajit, morën urdhëra nga policia serbe të hypnin në tren për në Han të Elezit, ku e kaluan në këmbë kufirin me Maqedoninë.

g. Prizren: Më 25 mars 1999, fshati Piranë u rrethua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë me tanke dhe llojlloj automjetesh ushtarake. Fshati është granatuar dhe një numër banorësh janë vrarë. Pastaj policët hynë në fshat dhe dogjën shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës. Pas sulmit, fshatarët e mbetur u larguan nga Pirana dhe shkuan në fshatrat përreth. Disa prej shqiptarëve të Kosovës, duke ikur në drejtim të Sërbicës, u vranë apo u plagosën nga snajperët. Forcat serbe pastaj filluan një ofensivë në rrethinën e Sërbicës, duke granatuar fshatrat Reti i Ulët, Reti, dhe Randobravë. Fshatarët shqiptarë të Kosovës u përzunë nga shtëpitë dhe u dërguan në kufirin me Shqipërinë. Prej 28 marsit 1999 në vetë qytetin e Prizrenit, policët serbë shkonin shtëpi për shtëpi, duke urdhëruar banorët shqiptarë të Kosovës të largoheshin. Ata u detyruan t'u bashkoheshin kolonave të automjeteve dhe të njerëzve që udhëtonin në këmbë drejt kufirit shqiptar. Në kufi, policët serbë ua morën të gjitha dokumentet personale.

h. Skënderaj: Më 25 mars 1999 apo rretk kësaj date, fshatrat Vojnik, Leçinë, Klladernicë, Turiçec, Brojë dhe Izbicë u shkatërruan nga granatimet dhe djegiet. Një grup prej afro 4,500 shqiptarësh të Kosovës prej këtyre fshatrave u mblodh afër fshatit Izbicë, ku pjesëtarët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë kërkuan të holla nga grupi dhe i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Një numër i madh i burrave pastaj u vra. Gratë dhe fëmijtë që mbetën gjallë u çuan në grup në drejtim të Vojnikut dhe pastaj në kufirin me Shqipërinë.

i. Suharekë: Në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan qytetin e Suharekës. Gjatë ditëve në vijim, policët shkonin shtëpi për shtëpi, duke kërcënuar banorët shqiptarë të Kosovës dhe duke nxjerrë shumë njerëz nga shtëpitë e trye nën tytën e pushkës. Gratë, fëmijtë dhe pleqtë u larguan nga policia dhe pastaj një numër burrash janë vrarë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Shqiptarët e Kosovës u detyruan të iknin me kamionë, traktorë dhe rimorkio drejt kufirit me Shqipërinë. Duke kaluar kufirin, u janë marrë të gjitha dokumentat dhe të hollat.

Më 31 mars 1999, rreth 80,000 shqiptarë të Kosovës të zhvendosur nga fshatrat e komunës së Suharekës u mblodhën afër Bellanicës. Të nesërmen, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e granatuan Bellanicën, duke detyruar të zhvendosurit të iknin drejt kufirit shqiptar. Para se të kalonin kufirin, u janë marrë të gjitha letërnjoftimet.

j. Ferizaj: gjatë periudhës prej 4 deri më 14 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i granatuan fshatrat Softaj, Rahovicë, Zllatar, Pojatishtë, Komogllavë dhe

Sojevë, duke vrarë një numër banorësh. Pas granatimit, automjete policore dhe ushtarake hynë në fshatra dhe urdhëruan banorët të largoheshin. Pasi fshatarët kishin dalë nga shtëpitë, ushtarët dhe policët i dogjën ato. Fshatarët e zhvendosur iu bashkuan një kolone për në kufirin me Maqedoninë. Në kufi u janë marrë të gjitha dokumentat.

98. Duke filluar nga 1 janari i vitit 1999 apo rreth kësaj dite dhe duke vazhduar deri në datën e kësaj aktakuze, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo me përkrahjen e **Sllobodan MILLOSHEVIQIT, Millan MILLUTINOVIQIT, Nikolla SHAINOVIQIT, Dragolub OJDANIQIT** dhe **Vllajko STOJILKOVIQIT** kanë vrarë qindra civilë shqiptarë të Kosovës. Këto vrasje janë bërë në mënyrë sistematike anembanë krahinës së Kosovës dhe kanë shkaktuar vdekjen e shumë burrave, grave dhe fëmijëve. Në vrasjet masive përfshihen këto raste:

a. Më 15 janar 1999 apo rreth kësaj dite, në orët e hershme të mëngjesit, fshati Reçak në komunën e Shtimjes u sulmua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Pas granatimit nga njësitë e UJ-së, policia serbe hyri në fshat më vonë në orët e paraditës dhe filloi bastisjet shtëpi për shtëpi. Fshatarët të cilët kërkonin të iknin prej policisë serbe u vranë kudo në fshat. Një grup prej afro 25 meshkujve u përpoq të fshihej në një ndërtesë, por u zbulua nga policia serbe. Ata u rrahën dhe pastaj u çuan në një kodër të afërt, ku policët i pushkatuan. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë rreth 45 shqiptarë kosovarë në Reçak dhe rrethinë. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën A, bashkëngjitur kësaj aktakuze si shtojcë.)

b. Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Bellacërkë në komunën e Rahovecit. Shumë banorë të Bellacërkës ikën te shtrati i një përroi jashtë fshatit dhe kërkuan strehim nën një urë hekurudhore. Derisa fshatarë të tjerë i afroheshin urës, një patrullë e policisë serbe hapi zjarr kundër tyre, duke vrarë 12 veta, 10 prej tyre gra dhe fëmijë. Policia pastaj urdhëroi fshatarët e tjerë të dilnin nga shtrati i përroit. Në këtë moment meshkujt u ndanë nga gratë dhe fëmijët e vegjël. Policia pastaj urdhëroi meshkujt të zhvisheshin dhe ua plaçkiti sistematikisht të gjitha sendet me vlerë. Grave dhe fëmijëve pastaj u dhanë urdhrin për t'u larguar. Mjeku i fshatit u përpoq të fliste me komandantin e policisë, por ai u pushkatua, si edhe nipi i tij. Meshkujt e tjerë pastaj u urdhëruan të ktheheshin në shtratin e përroit. Pasi zbatuan urdhërin, policia hapi zjarr kundër këtyre meshkujve, duke vrarë rreth 65 shqiptarë të Kosovës. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën B, bashkangjitur kësaj aktakuze si shtojcë.)

c. Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, fshatrat Krushë e Madhe dhe Krusha e Vogël në komunën e Rahovecit u sulmuan nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Banorët e fshatrave u strehuan në një pyll afër Krushës së Madhe, ku patën mundësi të shihnin policët që sistematikisht plaçkitën dhe pastaj dogjën shtëpitë e tyre. Më apo rreth 26 marsit, në orët e paraditës, policia serbe i gjeti fshatarët në pyll. Policia urdhëroi gratë dhe fëmijtë të largoheshin dhe të shkonin në Shqipëri. Policët pastaj i kontrolluan burrat dhe djemtë dhe ua morën letërnjoftimet. Pastaj i detyruan të ecnin drejt një shtëpie të pabanuar midis malit dhe Krushës së Vogël. Kur burrat dhe djemtë ishin mbledhur mbrenda shtëpisë, policia serbe hapi zjarr mbi ta. Pas të shtënave që zgjatën disa minuta, policia hodhi sanë mbi burrat dhe djemtë dhe e ndezi për t'i djegur kufomat. Si pasojë të pushkatimeve dhe të zjarrit, rreth 105 burra dhe djem shqiptarë të Kosovës janë vrarë nga policia serbe. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën C, bashkëngjitur kësaj aktakuze si shtojcë.)

d. Në mbrëmjen e 26 marsit të vitit 1999 apo rreth kësaj date, në qytetin e Gjakovës, serbë të armatosur erdhën në një shtëpi në Rrugën Ymer Grezda. Gratë dhe fëmijët brenda shtëpisë u ndanë nga burrat dhe u urdhëruan të ngjiteshin në katin e sipërm. Atëherë serbët e armatosur pushkatuan të gjashtë meshkuj shqiptarë të Kosovës që ishin në këtë shtëpi. (Emrat e të vrarëve janë radhitur në Shtesën D, bashkëngjitur kësaj aktakuze si shtojcë.)

e. Më 27 mars 1999 apo rreth kësaj date, në orët e mëngjesit, forca të RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Padalishtë të komunës së Istogut. Tek hynin në fshat, forcat qëlluan mbi shtëpitë dhe mbi fshatarët që përpiqeshin të iknin. Tetë anëtarë të familjes së Bekë IMERAJ-t u dëbuan forcërisht nga shtëpia dhe u vranë para shtëpisë së vet. Banorë të tjerë të Padalishtës janë vrarë në shtëpitë e tyre dhe në një shtrat përroi afër fshatit. Gjithsej, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë afro 20 shqiptarë të Kosovës nga Padalishta. (Të vrarët që dihen me emër janë radhitur në Shtesën E, bashkëngjitur kësaj aktakuze si shtojcë.)

f. Më 27 mars 1999 apo rreth kësaj dite, forcat e RFJ-së dhe të Republikës së Serbisë sulmuan fshatin Izbicë në komunën e Skënderajt. Disa mijëra banorë të fshatit u strehuan në një lëndinë afër fshatit. Më apo rreth 28 marsit 1999, forca të RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatarët dhe iu afruan atyre, duke u kërkuar para. Pasi ushtarët dhe policët u vodhën sendet me vlerë, i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët e vegjël. Meshkujt pastaj u ndanë në dy grupe. Njëri grup u dërgua në një kodër të afërt kurse tjetri u dërgua në shtratin e një përroi. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pastaj qëlluan mbi të dyja grupet dhe rreth 130 shqiptarë të Kosovës u vranë. (Të vrarët që dihen me emër janë radhitur në Shtesën F bashkëngjitur kësaj aktakuze si shtojcë.)

g. Në orët e hershme të mëngjesit të datës 2 prill 1999 apo rreth kësaj date, policia serbe filloi një aksion kundër lagjes Qerimi të Gjakovës. Gjatë një periudhe prej disa orësh, policia serbe hyri me forcë në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës në lagjen Qerimi, duke vrarë banorët dhe duke u vënë zjarrin shtëpive. Në bodrumin e një shtëpie në Rrugën Millosh Gilliq, policia serbe pushkatoi rreth 20 njerëz dhe i vuri zjarrin shtëpisë. Si pasojë e pushkatimeve dhe të zjarreve të ndezura nga policia serbe, 20 shqiptarë të Kosovës janë vrarë, duke përfshirë 19 gra dhe fëmijë. (Emrat e të vrarëve janë radhitur në Shtesën G, bashkëngjitur kësaj aktakuze si shtojcë.)

99. Duke filluar më 1 janar të vitit 1999 apo rrethkësaj dite dhe duke vazhduar deri në datën e kësaj aktakuze, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo me përkrahjen e **Sllobodan MILLOSHEVIQIT, Millan MILLUTINOVIQIT, Nikolla SHAINOVIQIT, Dragolub OJDANIQIT** dhe **VLLAJKO STOJILKOVIQIT,** kanë shfrytëzuar mënyrat dhe metodat e përshkruara në paragrafet 92 deri në 98 për të kryer një fushatë përndjekjeje kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës për arsye politike, racore, ose fetare.

100. Me këto veprime, **Sllobodan MILLOSHEVIQI, Millan MILLUTINOVIQI, Nikolla SHAINOVIQI, Dragolub OJDANIQI** dhe **Vllajko STOJILKOVIQI** planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo në mënyra të tjera ndihmuan planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e veprimeve me sa vijon:

**PIKA 1**
(Deportim)

**Pika 1:** Deportim, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (d) të Statutit të Tribunalit.

**PIKA 2**
(Vrasje)

**Pika 2**: Vrasje, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (a) të Statutit të Tribunalit.

**PIKA 3**
(Vrasje)

**Pika 3**: Vrasje, një **SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS**, e ndëshkueshme në bazë të Nenit 3 të Statutit të Tribunalit dhe e njohur në Nenin 3 (1) (a) (vrasje) të Konventave të Gjenevës.

**PIKA 4**
(Përndjekje)

**Pika 4**: Përndjekjet për arsye politike, racore, ose fetare, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (h) të Statutit të Tribunalit.

________________

Luizë Arbur (Louise Arbour)
Prokurore

22 maj 1999
Hagë, Holandë.

Shtesa A

Personat, emrat e të cilëve dihen, të vrarë në Reçak me 15 janar 1999.

| Emri | Mosha e përafërt | Gjinia |
|---|---|---|
| ASLLANI, Lute | 30 | Femër |
| AZEMI, Banush | | Mashkull |
| BAJRAMI, Ragip | 34 | Mashkull |
| BEQIRI, Halim | 13 | Mashkull |
| BEQIRI, Rizah | 49 | Mashkull |
| BEQIRI, Zenel | 20 | Mashkull |
| BILALLI, Lutfi | | Mashkull |
| EMINI, Ajet | | Mashkull |
| HAJRIZI, Bujar | | Mashkull |
| HAJRIZI, Myfail | 33 | Mashkull |
| HALILI, Skënder | | Mashkull |
| HYSENAJ, Haqif | | Mashkull |
| IBRAHIMI, Hajriz | | Mashkull |
| IMERI, Hakip | | Mashkull |
| IMERI, Murtez | | Mashkull |
| IMERI, Nazmi | | Mashkull |
| ISMAJLI, Meha | | Mashkull |
| ISMAJLI, Muhamet | | Mashkull |
| JAKUPI, Ahmet | | Mashkull |
| JAKUPI. Esref | 40 | Mashkull |
| JAKUPI, Hajriz | | Mashkull |
| JAKUPI. Mehmet | | Mashkull |
| JAKUPI. Xhelal | | Mashkull |
| JASHARI. Jashar | 24 | Mashkull |
| JASHARI, Raif | 20 | Mashkull |
| JASHARI, Shukri | 18 | Mashkull |
| LIMANI, Fatmir | 35 | Mashkull |
| LIMANI, Nexhat | 19 | Mashkull |
| LIMANI, Salif | 23 | Mashkull |
| MEHMETI, Bajram | | Mashkull |
| MEHMETI, Hanumshah | | Femër |
| METUSHI, Arif | | Mashkull |
| METUSHI, Haki | 70 | Mashkull |
| MUSTAFA, Ahmet | | Mashkull |
| MUSTAFA, Asllan | 34 | Mashkull |
| MUSTAFA, Muhamet | 21 | Mashkull |
| OSMANI, Sadik | 35 | Mashkull |
| SALIHU, Jashar | 25 | Mashkull |
| SALIHU, Shukri | 18 | Mashkull |
| SHABANI, Bajrush | 22 | Mashkull |
| SMAJLAJ, Ahmet | 60 | Mashkull |
| SYLA Sheremet | 37 | Mashkull |
| SYLA Shyqeri | | Mashkull |
| XHELADINI, Bajram | | Mashkull |
| ZYMERI, Njazi | | Mashkull |

Shtesa B

Personat, emrat e të cilëve dihen, të vrarë në Bellacërkë me 25 mars 1999.

| Emri | Mosha e përafërt | Gjinia |
|---|---|---|
| BEGAJ, Abdullah | 25 | Mashkull |
| BERISHA, Murat | 60 | Mashkull |
| GASHI, Fadil | 46 | Mashkull |
| MORINA, Musa | 65 | Mashkull |
| POPAJ, Abdullah | 18 | Mashkull |
| POPAJ, Agon | 14 | Mashkull |
| POPAJ, Alban | 21 | Mashkull |
| POPAJ, Bedrush | 47 | Mashkull |
| POPAJ, Belul | 14 | Mashkull |
| POPAJ, Ethem | 46 | Mashkull |
| POPAJ, Hazer | 77 | Mashkull |
| POPAJ, Hysni | 37 | Mashkull |
| POPAJ, Irfan | 41 | Mashkull |
| POPAJ, Isuf | 76 | Mashkull |
| POPAJ, Kreshnik | 18 | Mashkull |
| POPAJ, Lindrit | 18 | Mashkull |
| POPAJ, Mehmet | 46 | Mashkull |
| POPAJ, Mersel | 53 | Mashkull |
| POPAJ, Nazmi | 45 | Mashkull |
| POPAJ, Nisim | 35 | Mashkull |
| POPAJ, Rrustem | | |
| POPAJ, Sahid | 40 | Mashkull |
| POPAJ, Sedat | 47 | Mashkull |
| POPAJ, Shëndet | 17 | Mashkull |
| POPAJ, Vehap | 58 | Mashkull |
| POPAJ, Xhavit | 32 | Mashkull |
| SPAHIU (emri nuk dihet, e bija e Xhemalit) | | Femër |
| SPAHIU (emri nuk dihet. e bija e Xhemalit) | | Femër |
| SPAHIU (emri nuk dihet, e bija e Xhemalit) | | Femër |
| SPAHIU (emri nuk dihet, gruaja e Xhemalit) | | Femër |
| SPAHIU, Xhemal | | Mashkull |
| ZHUNIQI, Abedin | 37 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Agim | 51 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Bajram | 51 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Biladh | 67 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Çlirim | 40 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Dardan | 6 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Dardane | 8 | Femër |
| ZHUNIQI, Destan | 68 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Eshref | 55 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Fatos | 42 | Mashkull |
| ZHUNIQI (emri nuk dihet) | 4 | Mashkull |
| ZHUNIQI (emri nuk dihet, gruaja e Çlirimit) | | Femër |
| ZHUNIQI, (emri nuk dihet, i biri i Fatosit) | 16 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Hysni | 70 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Ibrahim | 68 | Mashkull |

| | | |
|---|---|---|
| ZHUNIQI, Kasim | 33 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Medi | 55 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Muhamet | 70 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Muharrem | 30 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Qamil | 77 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Qemal | 59 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Reshit | 32 | Mashkull |
| ZHUNIQI, Shemsi | 52 | Mashkull |

Shtesa C

Personat, emrat e të cilëve dihen, të vrarë në Krushën e Madhe me 26 mars 1999.

| Emri | Mosha e përafërt | Gjinia |
|---|---|---|
| ASLLANI, Adem | 68 | Mashkull |
| ASLLANI, Arsim | 34 | Mashkull |
| ASLLANI, Feim | 30 | Mashkull |
| ASLLANI, Muharrem | 66 | Mashkull |
| ASLLANI, Nexhat | 27 | Mashkull |
| ASLLANI, Nisret | 33 | Mashkull |
| ASLLANI, Përparim | 26 | Mashkull |
| AVDYLI, Bali | 72 | Mashkull |
| AVDYLI, Enver | 28 | Mashkull |
| BATUSHA, Ahmet | 38 | Mashkull |
| BATUSHA, Amrush | 32 | Mashkull |
| BATUSHA, Asllan | 46 | Mashkull |
| BATUSHA, Avdi | 45 | Mashkull |
| BATUSHA, Bekim | 22 | Mashkull |
| BATUSHA, Beqir | 68 | Mashkull |
| BATUSHA, Burim | 18 | Mashkull |
| BATUSHA, Enver | 22 | Mashkull |
| BATUSHA, Feim | 23 | Mashkull |
| BATUSHA (emri nuk dihet, i biri i Ismailit) | 19 | Mashkull |
| BATUSHA (emri nuk dihet, i biri i Zaimit) | 20 | Mashkull |
| BATUSHA, Haxhi | 28 | Mashkull |
| BATUSHA, Lirim | 16 | Mashkull |
| BATUSHA, Milaim | 32 | Mashkull |
| BATUSHA, Muharrem | 69 | Mashkull |
| BATUSHA, Njazi | 39 | Mashkull |
| BATUSHA, Osman | 65 | Mashkull |
| BATUSHA, Sefer | 19 | Mashkull |
| BATUSHA, Sejdi | 68 | Mashkull |
| BATUSHA, Skifter | 22 | Mashkull |
| BATUSHA, Sulejman | 46 | Mashkull |
| BATUSHA, Zaim | 50 | Mashkull |
| HAJDARI, Abaz | 40 | Mashkull |
| HAJDARI, Abedin | 17 | Mashkull |
| HAJDARI, Halil | 42 | Mashkull |
| HAJDARI, Halim | 70 | Mashkull |
| HAJDARI, Hysni | 20 | Mashkull |
| HAJDARI, Marsel | 17 | Mashkull |
| HAJDARI, Nazim | 33 | Mashkull |
| HAJDARI. Qamil | 46 | Mashkull |
| HAJDARI, Rasim | 25 | Mashkull |
| HAJDARI, Sahit | 36 | Mashkull |
| HAJDARI, Selajdin | 38 | Mashkull |
| HAJDARI, Shani | 40 | Mashkull |
| HAJDARI, Vesel | 19 | Mashkull |
| HAJDARI, Zenun | 28 | Mashkull |
| LIMONI, Avdyl | 45 | Mashkull |

| | | |
|---|---|---|
| LIMONI, Limon | 69 | Mashkull |
| LIMONI, Luan | 22 | Mashkull |
| LIMONI, Nehbi | 60 | Mashkull |
| RAMADANI, Afrim | 28 | Mashkull |
| RAMADANI, Asllan | 34 | Mashkull |
| RAMADANI, Bajram | 15 | Mashkull |
| RAMADANI (emri nuk dihet, i biri i Hysenit) | 23 | Mashkull |
| RAMADANI, Hysen | 62 | Mashkull |
| RAMADANI, Lutfi | 58 | Mashkull |
| RAMADANI, Murat | 60 | Mashkull |
| RAMADANI, Ramadan | 59 | Mashkull |
| RAMADANI, Selajdin | 27 | Mashkull |
| RASHKAJ (emri nuk dihet) | 16 | Mashkull |
| RASHKAJ (emri nuk dihet) | 18 | Mashkull |
| RASHKAJ, Refki | 17 | Mashkull |
| SHEHU, Adnan | 20 | Mashkull |
| SHEHU, Arben | 20 | Mashkull |
| SHEHU, Arif | 36 | Mashkull |
| SHEHU, Bekim | 22 | Mashkull |
| SHEHU, Burim | 19 | Mashkull |
| SHEHU, Destan | 68 | Mashkull |
| SHEHU, Din | 68 | Mashkull |
| SHEHU, Dritan | 18 | Mashkull |
| SHEHU, Fadil | 42 | Mashkull |
| SHEHU, Flamur | 15 | Mashkull |
| SHEHU (emri nuk dihet, i biri i Hazizit) | 20 | Mashkull |
| SHEHU (emri nuk dihet, i biri i Sinanit) | 18 | Mashkull |
| SHEHU, Haxhi | 25 | Mashkull |
| SHEHU, Haziz | 42 | Mashkull |
| SHEHU, Ismail | 68 | Mashkull |
| SHEHU, Ismet | 40 | Mashkull |
| SHEHU, Mehmet | 13 | Mashkull |
| SHEHU, Mentor | 18 | Mashkull |
| SHEHU, Myftar | 44 | Mashkull |
| SHEHU, Nahit | 15 | Mashkull |
| SHEHU, Nehat | 22 | Mashkull |
| SHEHU, Nexhat | 38 | Mashkull |
| SHEHU, Qamil | 50 | Mashkull |
| SHEHU, Sahit | 23 | Mashkull |
| SHEHU, Sali | 44 | Mashkull |
| SHEHU, Sami | 24 | Mashkull |
| SHEHU, Sefer | 44 | Mashkull |
| SHEHU, Shani | 34 | Mashkull |
| SHEHU, Shefqet | 38 | Mashkull |
| SHEHU, Sinan | 50 | Mashkull |
| SHEHU, Veli | 28 | Mashkull |
| SHEHU, Xhafer | 38 | Mashkull |
| SHEHU, Xhavit | 20 | Mashkull |
| SHEHU, Xhelal | 13 | Mashkull |
| ZYLFIU (emri nuk dihet, i biri i Halimit) | 18 | Mashkull |

| | | |
|---|---|---|
| ZYLFIU, Halim | 60 | Mashkull |
| ZYLFIU, Hamdi | 62 | Mashkull |
| ZYLFIU, Hamit | 22 | Mashkull |
| ZYLFIU, Hysen | 50 | Mashkull |
| ZYLFIU, Njazim | 24 | Mashkull |

Shtesa D

Personat, emrat e të cilëve dihen, të vrarë në Gjakovë me 26 mars 1999

| Emri | Mosha e përafërt | Gjinia |
|---|---|---|
| BEGOLLI, Sylejman | 48 | Mashkull |
| BYTYQI, Arif | 72 | Mashkull |
| BYTYQI, Urim | 38 | Mashkull |
| DERVISHDANA, Emin | 31 | Mashkull |
| DERVISHDANA, Fahri | 37 | Mashkull |
| DERVISHDANA, Zenel | 59 | Mashkull |

Shtesa E

Personat, emrat e të cilëve dihen, të vrarë në Padalishtë me 27 mars 1999.

| Emri | Mosha e përafërt | Gjinia |
|---|---|---|
| IMERAJ. Afrim | 2 | Mashkull |
| IMERAJ, Ardiana | 13 | Femër |
| IMERAJ, Arijeta | 11 | Femër |
| IMERAJ, Avdyl | 67 | Mashkull |
| IMERAJ, Bekë | 53 | Mashkull |
| IMERAJ, Feride | 21 | Femër |
| IMERAJ, Fetije | 42 | Femër |
| IMERAJ, Florije | 19 | Femër |
| IMERAJ, Gjylfidan | 15 | Femër |
| IMERAJ, Hasan | 63 | Mashkull |
| IMERAJ, Mihane | 72 | Femër |
| IMERAJ, Mona | 72 | Femër |
| IMERAJ, Muhamet | 19 | Mashkull |
| IMERAJ, Nexhmedin | | Mashkull |
| IMERAJ, Rab | 30 | Mashkull |
| IMERAJ, Rustem | 73 | Mashkull |
| IMERAJ, Sabahat | 21 | Mashkull |
| IMERAJ, Shehide | 70 | Femër |
| IMERAJ, Violeta | 17 | Femër |
| IMERAJ, Xhyfidane | 14 | Femër |

Shtesa F

Personat, emrat e të cilëve dihen, të vrarë në Izbicë me 28 mars 1999.

| Emri | Mosha e përafërt | Gjinia |
| --- | --- | --- |
| BAJRA, Bajram | 62 | Mashkull |
| BAJRA, Brahim | | Mashkull |
| BAJRA, Fazli | 60 | Mashkull |
| BAJRA, Ilaz | | Mashkull |
| BAJRA, Sami | | Mashkull |
| BEHRAMAJ, Demush | 60 | Mashkull |
| BEHRAMAJ, Muhamed | 50 | Mashkull |
| BEHRAMAJ, Nur | 85 | Mashkull |
| BEHRAMI, Ardita | | Mashkull |
| BEHRAMI, Demush | 75 | Mashkull |
| BEHRAMI, Edona | | Mashkull |
| BEHRAMI, Muhamet | | Mashkull |
| BEHRAMI, Nuredin | 90 | Mashkull |
| BEQIRI, Ajet | | Mashkull |
| CAKAJ, Demush | 65 | Mashkull |
| CAKAJ, Muhamet | 60 | Mashkull |
| CAKAJ, Nura | 80 | Mashkull |
| CAKAJ, Thair | 65 | Mashkull |
| CAKAJ, Zeqir | 80 | Mashkull |
| CELI, Metush | 62 | Mashkull |
| CELI, Rexhë | | Mashkull |
| CELI, Smajl | 67 | Mashkull |
| CUPEVA, Hamëz | 46 | Mashkull |
| DRAGA, Ali | 65 | Mashkull |
| DRAGA, Brahim | 72 | Mashkull |
| DRAGA, Cen | 68 | Mashkull |
| DRAGA, Hajriz | 43 | Mashkull |
| DRAGA, Halit | | Mashkull |
| DRAGA, Hazir | | Mashkull |
| DRAGA, Ismet | 28 | Mashkull |
| DRAGA, Jetulla | 60 | Mashkull |
| DRAGA, Murat | | Mashkull |
| DRAGA, Rahim | 70 | Mashkull |
| DRAGA, Rustem | 70 | Mashkull |
| DURAKU, Dibran | 65 | Mashkull |
| FEJZA, Zyra | | Mashkull |
| FETAHI, Azem | 75 | Mashkull |
| FETAHI, Hetem | 63 | Mashkull |
| FETAHI, Muharrem | | Mashkull |
| FETAHU, Lah | 67 | Mashkull |
| GASHI, Beqë | | Mashkull |
| GASHI, Brahim | 70 | Mashkull |
| GASHI, Deli | | Mashkull |
| GASHI, Hajrullah | | Mashkull |
| GASHI, Ram | 57 | Mashkull |
| HAJRIZI, Fata | | Mashkull |
| HASANI, Nezir | | Mashkull |
| HAXHA, Bajram | 78 | Mashkull |

| | | |
|---|---|---|
| HAXHA,.Fejz | 86 | Mashkull |
| HOTI, Muhamet | | Mashkull |
| JETULLAHU, Beqir | | Mashkull |
| KELMENDI, Bajram | | Mashkull |
| KELMENDI, Beqir | | Mashkull |
| KRASNIQI, Deli | 80 | Mashkull |
| KRASNIQI, Mustafë | | Mashkull |
| KRASNIQI, Rahim | 62 | Mashkull |
| KRASNIQI, Rahim | | Mashkull |
| LATIFI, Jetullah | | Mashkull |
| (mbiemri nuk dihet), Qazim | 70 | Mashkull |
| MUSLIA, Shaban | 75 | Mashkull |
| MUSTAFA, Hasan | 70 | Mashkull |
| NEBIHI, Selim | 95 | Mashkull |
| OSMANI, Azem | 75 | Mashkull |
| OSMANI, Hetem | 70 | Mashkull |
| OSMANI, Muharrem | 90 | Mashkull |
| RACI, Ramadan | 56 | Mashkull |
| RAMA, Halit | 60 | Mashkull |
| REXHEPI, Muji | 47 | Mashkull |
| REXHEPI, Zaim | 38 | Mashkull |
| RUSTEMI. Halit | 60 | Mashkull |
| SALIHU, Zeqir | | Mashkull |
| SEJDIU, Bajram | | Mashkull |
| SEJDIU, Mustafë | 41 | Mashkull |
| SHALA, Kujtim | 47 | Mashkull |
| SHALA, Isuf | | Mashkull |
| SHALA, Sali | 35 | Mashkull |
| SPAHIU, Rizah | | Mashkull |
| TAHAJ, Ethem | 65 | Mashkull |
| TAHAJ, Muharrem | 75 | Mashkull |
| TAHI, Azem | 60 | Mashkull |
| TAHI, Hetem | 50 | Mashkull |
| TAHI, Muharrem | 70 | Mashkull |
| TAHIRI, Brahim | | Mashkull |
| TAHIRI, Rrahim | | Mashkull |
| THAÇI, Hamit | 70 | Mashkull |
| THAÇI, Haxhi | | Mashkull |
| THAÇI, Jetullah | | Mashkull |
| THAÇI, Ramë | | Mashkull |
| THAÇI, Sahit | | Mashkull |
| THAÇI, Salih | | Mashkull |
| THAÇI, Ukë | 80 | Mashkull |
| XHEMAJLI, Esat | | Mashkull |
| XHEMALI, Demush | 87 | Mashkull |
| XHEMALI, Idriz | 67 | Mashkull |

Shtesa G

Personat, emrat e të cilëve dihen, të vrarë në Gjakovë me 2 prill 1999.

| Emri | Mosha e përafërt | Gjinia |
|---|---|---|
| CAKA, Dalina | 14 | Femër |
| CAKA, Delvina | 6 | Femër |
| CAKA, Diona | 2 | Femër |
| CAKA, Valbona | 34 | Femër |
| GASHI, Hysen | 50 | Mashkull |
| HAXHIAVDIJA, Doruntina | 8 | Femër |
| HAXHIAVDIJA, Egzon | 5 | Mashkull |
| HAXHIAVDIJA, Rina | 4 | Femër |
| HAXHIAVDIJA, Valbona | 38 | Femër |
| HOXHA, Flaka | 15 | Femër |
| HOXHA, Shahindere | 55 | Femër |
| NUÇI, Manushe | 50 | Femër |
| NUÇI, Shirine | 70 | Femër |
| VEJSA, Arlind | 5 | Mashkull |
| VEJSA, Dorina | 10 | Femër |
| VEJSA, Fetije | 60 | Femër |
| VEJSA, Marigona | 8 | Femër |
| VEJSA, Rita | 2 | Femër |
| VEJSA, Sihana | 8 | Femër |
| VEJSA, Tringa | 30 | Femër |